

AKT THEMELIMI I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“AK & AM “ shpk

Ne Tirane, sot me date 09.12.2021, me cilesine e “ortakeve themelues “ une :

Aldi Mucaj, i biri i Basshkim-it , i dtl. 17.02.1988, lindur ne Kamez dhe banues ne adresen Bulevardi Blu Kamez Tirane , shtetas shqiptar, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtes i leternjoftimit Id.Nr Personal I80217100V

Arlind Aga i biri i Ismail-it i dtl. 07.04.1990, Lindur ne Fajza dhe banues ne Kamez Tirane , madhore, me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, mbajtes i leternjoftimit me nr. Personal J00407011C me vullnet të lire, të plote e të sinqerte, mbeshtetur ne :

Kushtetuten e Republikes se Shqiperise dhe Kodin Civil ne fuqi, ne ligjin 9901 date 14.04.2008, “ Per Tregtaret dhe Shoqerite tregtare “ te ndryshuar me ligjin 129/2014, ne ligjin 9723, datë 3.5.2007 Për Regjistrimin e Biznesit”, i ndryshuar,”, ne Kodin Doganor, Fiskal e Tatimor, kemi vendosur krijimin e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar me emertimin “AK & AM “ shpk, (me poshte e quajtur “Shoqeria“)

KREU I

Neni 1

Krijimi

Shoqeria “AK & AM “ shpk, eshte person juridik i te drejtes shqiptare, Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (me poshte e quajtur “Shoqeria”).

Neni 2

Personaliteti juridik

Shoqeria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në QKB, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqëria “AK & AM “ shpk , është një shoqëri tregtare, e themeluar nga “ortaket, te cilet nuk përgjigjet për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulon personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkuara. Kontributi i ortakeve përbën kapitalin e regjistruar të shoqërisë.

Ortaket gëzojnë kuotën e tij në shoqëri, në përpjesëtim me kontributin që ka dhënë në kapital.

Neni 3

Selia

Shoqeria e ka seline kryesore ne adresen; Bulevardi Blu afer Credins Bank Kamez Tirane.

Shoqeria mund te ndryshoje seline e tij, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashte Republikes se Shqiperise, vetëm me vendim te Asamblese se Ortakeve.

Neni 4

Objekti i veprimtarise

Kembimin e valutave. Agjensi Udhetimi. Qender fizioterapie. Argjendari import export me shumice dhe pakice. Ne fushen e aktivitetit si agjensi e transportit te udhetareve per shitjen e biletave ne transportit nderkombetar ajror, detar, brenda dhe jashte territorit te Shqiperise si dhe siguracion i shendetit ne udhetim dhe siguracion pasuri te luajtshme. Ne fushen e turizmit si agjensi turistike. Organizimi i udhetimeve turistike, per ne Shqiperi dhe jashte saj, renta car, drejtimin e qendrave turistike, dhenien e asistences per pritjen e turistave te huaj, eksport importimin e mallrave te ndryshem industriale, bujqesore, blegtorale makineri e pajisje e pjese kembimi, lende te para dhe te perpunuara dhe çdo gje tjeter qe eshte e nevojshme per arritjen e qellimeve te mesiperme. agjencise se udhetimeve dhe turistike dhe me mundesine qe te marre persiper perfaqesimin shitje biletash te trenave, anijeve dhe avioneve. Organizimin e udhetimeve dhe te

qendrimit turistik per invalide dhe/ose per grupe dhe per ndermjetesimin e shitjes se produktit turistik ne te gjitha format e tij.Mundesit per prentimin e sherbimeve turistik si prentime per hotele, vendqendrimet, fshatra turistike, prentime dhe /ose marrje me qera te mjeteve te transportit (autovetura, autobuz, anije), prentime vaktesh dhe restorante.Organizimin sherbimesh qe kane lidhje me pritjen turistike si dhe ndihme ne aeroporte, organizime vizitash, eskursionesh dhe hyrje neper muzera, sherbim guide. ndermjetesim ne shitjen e produktit turistik permes operatoreve kryesore turistike (tur operators), administrim dhe realizim i strukturave turistike. Keto sherbime mund te jene si per kliente individuale ashtu dhe per grupe, te tilla sherbime mund te programohen perpara ose te kryhen ne moment, sipas kerkesave te rastit.

Neni 5

Kohezgjitja

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij per nje periudhe kohore te papercaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit ne QKB.

KREU II

KAPITALI

Neni 6

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 4 500 000 lekë dhe eshte i perbere nga 2 kuota.

Kapitali i mesiperm eshte nënshkruar tërësisht ne te holla nga ortakët e shoqerise perkatesisht:

Z.Aldi Mucaj, zoterues i 1 kuotave, qe perfaqesojne 49 % te kapitalit themeltar te shoqerise, me vlere te pergjithshme 2 205 000 leke,

Z.Arlind Aga, zoterues i 1 kuotave, qe perfaqesojne 51 % te kapitalit themeltar te shoqerise, me vlere te pergjithshme 2 295 000leke,

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme.

Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/ të paluajtshme apo të drejta).

Ortaku, që pengohet të ushtrojë të drejtat, që i rrjedhin nga zotërimi i kuotës së shoqërisë, ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës të urdhërojë ndalimin e cenimit apo shpërblimin e dëmit të shkaktuar, si pasojë e cenimit të këtyre të drejtave. Kjo e drejtë parashkruhet brenda 3 vjetëve nga çasti i cenimit.

Neni 7

Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, dhe ne sherbime, nepermjet emerimit te nje eksperti te autorizuar per keto kontribute ne natyre.

Kapitali i regjistruar i shoqërisë mund të zvogëlohet me vendim të Ortakeve me te njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

Vendimi për zvogëlimin e kapitalit i njoftohet Qendrës Kombëtare e Biznesit për regjistrim nga administratori, në përputhje me nenin 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 Për Regjistrimin e Biznesit", i

ndryshuar.

Neni 8

Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

KREU II

ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 9

Organi Vendimmarres

Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve është organi i vetëm vendimmarres i shoqërisë.

Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve është organi i vetëm vendimmarres i shoqërisë, që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të percaktuara në ligj.

Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Neni 10

Administrimi

Administrator i shoqërisë është Z. Arlind Aga.

Administratori i shoqërisë do të ushtroje kompetencat e administrimit për një afat 5 vjeçar me të drejte ripërteritje.

Administratori emrohet dhe shkarkohet me vendim i asamblese së ortakëve të shoqërisë. Administrator i shoqërisë mund të emrohet edhe një person i tretë jashtë ortakërisë.

Neni 11

Kompetencat

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- d) përgatit dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- dh) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) Administratori në respekt të dispozitave ligjore, mund të kryejë të gjitha operacionet që do të jnë të konsideruara nga administratori të nevojshme dhe të dobishme për të arritur objektivat sociale aty përfshirë leshimin e garancive reale dhe personale dhe besimeve edhe ndaj personave të tretë.
- f) raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

Administratori është i detyruar të thërrasi asamblesën e përgjithshme edhe në rastet kur :

Asambleja e përgjithshme thirret pasi, sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezultojnë ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkuar brenda 3 muajve në vazhdim dhe

kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara,

Administratori ka të drejtë të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoriteteve shtetërore shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkalleve. Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji dhe ky statut ia jep shprehimisht ortakëve të shoqërisë.

Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

Neni 12

Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqërisë ne Qendren Kombetare te Biznesit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 13

Bilanci i shoqërisë dhe dividendet

Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit financiar, Mbledhja e Ortakeve, miraton bilancin e paraqitur nga Administratori.

Mbledhja e Ortakeve vendos rreth shperndarjes se dividendit, pasi te jene zbritur humbjet e vitit te meparshem financiar, siç edhe parashikohet nga ligji.

Neni 14

Baza Ligjore

Shoqëria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptare.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqërite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

Neni 15

Dispozita perfundimtare

Ky Akt themelimi i shoqërisë "AK & AM " shpk, u redaktua nga une "ortaket themelues" ne 4 ekzemplare me vlera te njejta juridike ne gjuhen shqipe me permbajtje dhe vlera te njejta juridike.

ORTAKET E SHOQËRISE

"AK & AM " shpk

Aldi Mucaj

Arlind Aga

